

AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ILIRIA 2020“ shpk

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, sot më datë 13/05/2019, krijohet shoqëria tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “**ILIRIA 2020**“ shpk.

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “**ILIRIA 2020**“ SHPK.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria “**ILIRIA 2020**“ shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga ortaku i vetëm, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën L. “Kastriot”, Rr. “Brigada e XI Sulmuese”, Fier, me numer pasurie 5/430+1-41, Volumi 45, Faqe 83, numri i zonës kadastrale 8534.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti

Shoqëria “**ILIRIA 2020**” shpk., ka për objekt: “Kryerjen e çdo aktiviteti të lejuar me ligj dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryej një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi. Investitor dhe ndërtues i objekteve të ndryshme civile dhe industriale, private dhe shtetërore, social kulturore, me fonde publike, private, donacione, etj. Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje e objekteve të ndryshme. Restaurime të objekteve të ndryshme. Punime të kategorisë: NP-1, NP-2, NP-3, NP-4, NP-5, NP-6, NP-7, NP-8, NP-9, NP-10, NP-11, NP-12, NS-1, NS-2, NS-3, NS-4, NS-5, NS-6, NS-7, NS-8, NS-9, NS-10, NS-11, NS-12, NS-13, NS-14, NS-15, NS-16, NS-17, NS-18, NS-19



dhe NS-20. Shërbime të punimeve mekanike, ngrohje, kondicionim dhe hidrantit kundra zjarrit. Mirëmbajtje ashensorëve. Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje i rrjeteve të oksigjenit. Import-eksport, prodhim dhe tregtim i makinerive/pajisjeve/materialeve/produkteve, të ndryshëm industriale, të ndërtimit, tulla, mermer, vegla pune, vegla ndërtimi, prodhimeve të betonit, asfalt, binder, rërë bituminoze, shtylla betoni/metalike, materiale elektrike për tensionin e ulët, mesëm dhe të lartë, tuba, rakorderi dhe materiale për ujesjelles, KUZ – KUB – KUL, inerte, hekur, elektrike civile dhe industriale, paneleve të mbrojtjes dhe komandimit, transformator, elektronike, hidraulike, hidrosanitare, kondicionimi dhe ventilimi, elektro-shtëpiake, elektrovinca, ndricimi, audio, video, artikujve shkollor, kancelari, telefona, kompjutera, software, fotokopje, printera, skanera, bujqësore, duralumini, plastike, pllaka, bojë, drusore, goma, materiale pastrimi, metrazhe dhe uniformave pune, veshmbathjeve, tekstile, pompa, guzhine, fikese zjarri, etj. dhe shërbime për mirëmbajtjen, riparimin, vendosjen, montimin dhe pjesë këmbimi të këtyre pajisje/materiale/produkte. Import-eksport, prodhim dhe tregtim makinerive/pajisjeve/materialeve/produkteve të ndryshme ushqimore, blegtorale, të mishit dhe nënprodukteve të tij, sallameri e c' do nënprodukt të tij. Mbarështimi, rritja, dhe tregtimi i gjesë së gjallë, thertore, tregtimi dhe pikë shitje. Gurorë, impiante betoni, impiante asfaltbetoni, impiante të konglomerateve bituminoze. Import-eksport, tregtim dhe punime zdrukhtari, prodhim mobilje, bufe, dyer, dritare, etj. Fidanishte, pemë, shkurre dekorative, lule. Import-eksport dhe tregtim, shitëblerje, marrje/dhënie me qira apo forma të tjera kontraktuale, I makineri, pajisje, automjete, mjete/makineri/pajisje motorrike dhe jomotorrike të çfardo marke, tipi dhe tonazhi, për përdorim tëkësor, detar apo ajëror, pjesë këmbimi dhe shërbime/servis për këto mjete. Import, instalim, menaxhim impiante industriale dhe makineri pajisje. Mbushje kolaudim dhe shiteblerje fikse Zjarri. Punime në sipërfaqe të gjelbëra, parqe, pyje. Pastrimi dhe gjelberim i sipërfaqeve urbane, të ambjentëve publike dhe private, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Mirëmbajtjeje, zhvillimi i dekorit në mjedisin urban. Shërbime të pastrimit dhe rregullimit të sipërfaqeve. Shërbime të grumbullimit, largimit dhe të transportit të mbetjeve urbane. Import-eksport, prodhim, tregtim, pike shitje i oksigjenit, i të gjitha llojeve të karburanteve, gazit dhe nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikantë, kimikate, dru, qymyr guri, materiale për ngrohje. Lavazho, gomisteri. Lavanderi. Mulli bloje, furrë buke dhe tregtimi i produkteve të tyre. Shërbime transport mallrave dhe personave, për llogari të vetë apo për të tretë, brenda dhe jashtë vendit, me mjete tokësore, ujore dhe ajërore. Studio projektimi. Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarrit të ndërtesave të çdo lloji, hartimi i akteve të ekspertizës teknike për zjarret e rëna. Hartim i raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, kryerje e auditimit mjedisor, hartimi I ekspertizave për probleme mjedisore dhe vlerësim I raportëve të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi. Shërbim hoteleri, turizem, bar, restorant, bufe. Shërbim katering. Agjensi turistike. Agjensi shitje biletash të transportit urban, hekurudhor, ajror dhe detar. Agjensi imobiliare për shitëblerjen, dhënien/marrjen me qira, apo forma të tjera kontraktuale të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Kryerje testesh dhe provash laboratorike në fushën e materialeve të ndërtimit, provave dhe strukturave në ndërtim, provave të gjeoteknikës dhe gjeologjisë, vetite fiziko kimike të ujrave, dhe testime për vlerësimin e ndikimeve në mjedis”.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR.

**KREU II**  
**KAPITALI**  
**Neni 6**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 10.000 lekë dhe eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem" i shoqerise.

**Ortaku Themelues:** Ilir Shyqyri MORINA, zoterues i 1 (nje) kuote, me vlere te pergjithshme 10.000 Leke, qe perbene 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Ky kapital do te ngurtesohet ne Banke pasi te dali NIPTI i shoqerise.

**Neni 7**

**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**

**Organi Vendimmarres**

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;



- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;
  - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 9

##### Administrimi

Administrator i shoqërisë "**ILIRIA 2020**" shpk është **z. Ilir Morina**, i biri i Shyqyri, i datelindjes 17/03/1987, lindur në Fier e banues në Hamil shtetas shqiptar, madhor, me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar, mbajtes i Leternjoftimit (ID), me numer 025891344 dhe me numer personal I70317020I, i cili do të ushtroje funksionet në këto detyra për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

#### Neni 10

##### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 12

##### Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

#### Neni 13

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Por sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodin Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 14

Mosmarreveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "ILIRIA 2020" shpk, dhe nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

**ORTAKU THEMELUES**

A handwritten signature in blue ink is written over a horizontal line. The signature is cursive and appears to read "Lirio M...". Below the line, there are some additional blue ink strokes that extend downwards and to the left.